

Hapet Thirrja për Bursa për Studentët në Kuadër të Programit Erasmus+ në Universitetin Eberswalde, Gjermani

Në kuadër të Programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për semestrin e dytë të vitit akademik për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Eberswalde në Gjermani.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (1 semestër);
- Master (1 semestër);

Fushat e studimit:

- International Forest Ecosystem Management (zhvillohet pjesërisht në gjuhën angleze, studenti do të duhet të zgjedhë nga modulet e ndryshme të të gjithë programit të studimit) - vetëm për studentët Bachelor

-Landschaftsnutzung und Naturschutz (German-C1)/ Përdorimi dhe ruajtja e peizazhit - vetëm për studentët Bachelor

- Forstwirtschaft (German-C1)/Pylltari - vetëm për studentët Bachelor

- Regionalentwicklung und Naturschutz (German-C1)/ Zhvillimi rajonal dhe ruajtja e natyrës - vetëm për studentët Master

- Sustainable Tourism Management /Nachhaltiges Tourismusmanagement (German C1 & English B2) - Menaxhimi i Turizmit të Qëndrueshëm / Menaxhimi i Turizmit të Qëndrueshëm (Gjermanisht C1 & B2) - vetëm për studentët Master

Kini kujdes pasi Fusha e studimit të mësipërm mund të mos ofrohet e gjitha në gjuhën angleze por mund të ofrohet dhe pjesërisht në gjuhën gjermane.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor 800 Euro në muaj për studentët;
- Kostot e udhëtimit (275 Euro)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor/ Master:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Vërtetim studenti (e përkthyer në Gjuhën Angleze);
- Listë notash (nëse nuk lëshohet nga fakulteti juaj në gjuhën angleze atëherë lista e notave duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht ose Gjermanisht në bazë të programit të studimit që do të ndiqni);
- **Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Eberswalde lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti** dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Afati për aplikim: **10 Janar 2018**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!